**REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI**
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**

**MAMUŞA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS**
**OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA**

# B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES[1]

*Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik*

**Titulli i kontratës: "Mirëmbajtja dhe riparimi i ndërtesave të Komunës së Mamushës dhe institucioneve vartëse"**

**Numri i aktivitetit te prokurimit:**

| | |
|---|---|
| **Nr. i prokurimit**[2] | **626-23-2086-1-2-1** |
| **Nr i brendshëm** | **626-23-007-1-2-1** |

| Nr. | Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës | Çmimi i poentuar | Çmimi për njësi i të gjithë artikujve |
|---|---|---|---|
| 1. | "TRIANGLE" SH.P.K. rr.Brigada123, Suharekë. | **665.01€** | **4,207.30€** |
| 2. | **BAJRAM HA.GASHI B.I. Suharekë.** | **2,467.55 €** | **17,179.50 €** |
| 3. | **Grupi i Operatorëve Ekonomik "AS Tech" SH.P.K.; Shkelqimi Invest SH.P.K. TRINGË SMAJLI, RISHTINË** | **3,814.53 €** | **26,868.10 €** |

Rezultati i aktivitetit të prokurimit:

***Komuna e Mamushës - Zyra e Prokurimit,*** **shpërblen** me kontratë Operatorin Ekonomik të përgjegjshëm me çmimin më të ulët në bazë të poentimit: **BAJRAM HA.GASHI B.I. Suharekë** në vlerë totale të çmimit të poentuar prej: **2,467.55 €.**

Data: **29.05.2023**

Emri dhe mbiemri i ZPP: **Gazmend Gashi**
Nënshkrimi: ____________

**Këshillë juridike: Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj janë shkelur nga vendimi i autoritetit kontraktues gjatë kryerjes së këtij aktiviteti të prokurimit, mund të bëjë kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 ne adresën e Autoritetit Kontraktues, përmes platformës elektronike.**

[1] Këtij formulari i bashkëngjiten edhe letrat standarde te njoftimeve: B42, B45 dhe B46.( shtoni letra njoftuese sipas nevojës).
[2] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.

# B42 Letër standarde për tenderuesin e eliminuar [3]

*Mamushë me:* **29.05.2023**

*Komuna e Mamushës – Zyra e Prokurimit Mamushë*

*Për:* **Operatorin Ekonomik** "TRIANGLE" SH.P.K. rr.Brigada123, Suharekë

| | |
|---|---|
| **Nr. i prokurimit [4]** | 626-23-2086-1-2-1 |
| **Nr i brendshëm** | 626-23-007-1-2-1 |

**Titulli:**
**"Mirëmbajtja dhe riparimi i ndërtesave të Komunës së Mamushës dhe institucioneve vartëse"**

I/E nderuar/a Z/Znj. **Arian Bytyqi**

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP ".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kritereve të dhëna në Njoftimin për Kontratë dhe ne Dosjen e Tenderit.Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

- ☐ Certifikatat apo dëshmitë e kërkuara te cilat tregojnë apo pohojnë se nuk jeni i diskualifikuar nga ndonjë masë nën Nenin 65 të LPP;

- ☐ Certifikatën, dokumentin ose ndonjë dëshmi tjetër të mjaftueshme te kërkuar sipas Nenit 66 të LPP për të dëshmuar përshtatshmërinë profesionale tuaj;

- ☐ Dëshmi të mjaftueshme, siç është përshkruar në nenet 68 dhe 69 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbushni kërkesat minimale të gjendjes ekonomike dhe financiare dhe te kapacitetit teknik/profesional të saktësuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës.

*Tenderi i juaj* është administrativisht i papërgjegjshëm:

- ☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat e sigurisë së tenderit;
- ☐ Nuk e keni plotësuar dhe nënshkruar si duhet *[Formularin e paraqitjes së tenderit] [Formularin e paraqitjes së aplikacionit];*
- ☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat e vlefshmërisë së tenderit;

---

[3] *Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ngase kanë qenë te pa përgjegjshëm dhe të parregullt .*
[4] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.

- ❑ Nuk i keni paraqitur numrin e mjaftueshëm të kopjeve të kërkuara;
- ❑ Nuk e keni paraqitur deklaratën e cila identifikon nënkontraktuesit e zgjedhur për aktivitetin relevant te prokurimit;
- ☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat fomale/administrative
- ☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare
- ☐ *Nëse është e zbatueshme, kërkesa tjera formale/administrative.*
- ☒ *Keni dorëzuar tender jo-normalisht të ulët.*

*[Në rast të Grupit të Operatorëve Ekonomik]*-N/A

- ❑ Nën-kontraktuesi (t) juaj nuk i ka përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë.

*[Tenderi i juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje]* është i papërgjegjshëm sepse nuk keni dorëzuar:

ARSYETIM
Tenderi juaj është refuzuar për arsyen si vijon:

Komisioni vlerësues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderit të paraqitur nga Operatori Ekonomik "Triangle" SH.P.K. duke u bazuar në rregullat për Prokurimin Publik nr.001/2022 në dipozitat për tenderët jo normalisht të ulët, konstatoi se ky O.E. në disa artikuj ka ofruar tender jo normalisht të ulët në krahasim me objektin e kontratës, ndërsa në disa artikuj tjerë ka ofruar çmime tepër të larta në krahasim me çmimet e tregut. Komisioni ka kërkuar sqarim nga O.E. dhe në afat të kërkuar ka pranuar sqarimet të cilat për komisionin, kanë qenë të pa mjaftueshme dhe jo bindëse, pasi që nuk ka ofruar dëshmitë e kërkuara si referencat në të cilat është bazuar me rastin e vendosjes së çmimeve si dhe si dëshmi nuk ka dërguar kopje të faturave, pro-faturave apo të ofertave në të cilat evidentohen artikujt e cekur në kërkesën për sqarimin e tenderit me arsyetimin që dokumentet e kërkuara nuk mund të dërgohen pasi që ato janë konfidenciale mes O.E. dhe furnitorit dhe se është arsyetuar që për shkak që furnizohen me sasi të madhe gjatë vitit kanë rabat nga kompanitë furnizuese. Ndërsa si përparësi ka deklaruar se shumicën e materialeve i ka në stok por që nuk ka ofruar kurrfarë dëshmie për një gjë të tillë.

Duke u bazuar në Rregulloren për Prokurimin Publik, dispozitat për tenderët Jo-normalisht të ulët, komisioni konstatoi se Operatori Ekonomik "TRIANGLE" SH.P.K. ka ofruar tender jo normalisht të ulët pasi që i ka përmbushur të gjitha kushtet e parapara në nenin 41 paragrafi 41.1 pika i. ii. iii. pasi që janë dorëzuar tre tenderë, tenderi i dorëzuar nga Operatori Ekonomik "TRIANGLE" SH.P.K. ka qenë më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm dhe çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët.

Andaj, në bazë të nenit 61 të LPP-s, Rregullores për Prokurimin Publik neni 4 paragrafi 4.1 pika c dhe neni 41 Paragrafët 41.8 dhe 41.10 pika b Operatori Ekonomik, nuk ka dhënë ndonjë sqarim në lidhje me ekonominë e procesit të shërbimeve, çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicionin e O.E. për ekzekutimin e projektit që është duke u prokuruar. Gjithashtu nuk ka dhënë, informata shtesë mbi koston e shërbimeve të propozuara, por vetëm është zotuar dhe ka pranuar që do ta respektoj kontratën dhe se pasi që në disa artikuj ka dhënë çmimin jo normalisht të ulët dhe në disa artikuj çmime tepër të larta, ka llogaritur që deri në përfundim të kontratës çmimet e ulëta të mbulohen nga çmimet tepër të larta dhe se oferta është llogaritur në tërësi dhe jo për artikuj. Prandaj duke marrë parasysh se shpjegimi nuk ka qenë i mjaftueshëm dhe bindës, si dhe O.E. nuk ka ofruar referencat në të cilat i ka bazuar çmimet e ofruara, tenderi i është refuzuar.

***Lëshimi i cekur më lart ka bërë që ju të eliminoheni nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në tenderin në fjalë.***

**Në lidhje me refuzimin e tenderit tuaj si tenderit jo-normalisht të ulët është njoftuar edhe Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – KRPP, Departamenti i Monitorimit.**

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t`i përdorim shërbimet tuaja këtë here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

**Gazmend Gashi**
*(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)*

*(Nënshkrimi)*

## B45 - Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm[5]

**Mamushë më: 29.05.2023**

**Komuna e Mamushës- Zyra e Prokurimit**

**Për: Operatorin Ekonomik: BAJRAM HA. GASHI B.I. Suharekë**

| | |
|---|---|
| **Nr. i prokurimit**[6] | **626-23-2086-1-2-1** |
| **Nr i brendshëm** | **626-23-007-1-2-1** |

**Titulli:**
**"Mirëmbajtja dhe riparimi i ndërtesave të Komunës së Mamushës dhe institucioneve vartëse"**

I nderuar Z. **Bajram Gashi**

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092,siç citohet në vazhdim "LPP ".
Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin për kontrate dhe në dosjen e tenderit.

Kemi kënaqësinë të ju njoftojmë se ju keni dorëzuar **tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët,** si përgjigje ndaj **kërkesës për tenderin** *në lidhje me* aktivitetin e prokurimit te lartcekur.

Juve ju është dhënë kontrata me çmimin e saktësuar në tenderin tuaj dhe në pajtim me afatet dhe kushtet e dosjes së tenderit.

Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimit te intervalit, *gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.*

Bashkëngjitur me këtë letër është vendimi për dhënie të kontratës

Me respekt,

Gazmend Gashi

*Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit* *Nënshkrimi*

[5] *Kjo letër është për ofertuesin të cilit i është dhënë kontrata*
[6] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.

**B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**

REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

MAMUŞA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA

# B46 – Letër standard për tenderuesin e pasuksesshëm

**Mamushë më: 29.05.2023**
**Komuna e Mamushës- Zyra e Prokurimit**

**Për: Grupin e Operatorëve Ekonomik- "AS Tech" SH.P.K.; Shkelqimi Invest SH.P.K. TRINGË SMAJLI, RISHTINË**

| | |
|---|---|
| Nr. i prokurimit [7] | 626-23-2086-1-2-1 |
| Nr i brendshëm | 626-23-007-1-2-1 |

**Titulli:**
**"Mirëmbajtja dhe riparimi i ndërtesave të Komunës së Mamushës dhe institucioneve vartëse"**

I/E nderuar/a Z.Znj. **Afrim Sadiku**

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kritereve të dhëna në Njoftimin për Kontratë dhe ne Dosjen e Tenderit.
Me keqardhje ju njoftojmë se tenderi i paraqitur nga ana juaj nuk qe i suksesshëm, ngase tenderi juaj **nuk është tenderi me çmim më të ulët sipas poentimit** në mesin e tenderëve që plotësonin kërkesat e dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

**Ju informojmë se kontrata për tenderin në fjalë i është dhënë Operatorit Ekonomik BAJRAM HA. GASHI B.I. Suharekë për një vlerë të përgjithshme për çmimin e poentuar prej 2,467.55 €.**

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.
Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimin e intervalit, *gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit.*

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t`i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit .
Bashkëngjitur me këtë letër është vendimi për dhënie të kontratës

Me respekt,

Gazmend Gashi

*Emri dhe mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit* *Nënshkrimi*

[7] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.

**B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**